



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
Sektori i Shërbimit Social

PROJEKT VENDIM

Nr. 02 datë 7 .03.2023

"Për pranimin e të moshuares zj. Gjelinë Toma në Qendrën e perkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa ", Barbullush

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në ligjin 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" në vkm 518, datë 04.09.2018" Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masen e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar " Kreu III Pika 13. A); pika 14; pika 17; pika 18; pika 23.a): pika 24; Kreu IV " Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes " Pika 58, c) pika 59; si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarit:

PROPOZOJMË

1-Pranimin në qendrën e perkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush të zj. Gjelinë Toma me nr ID E05303163T duke i ofruar:

- Strehim
- Ushqim
- Përkujdesje Shëndetësore
- Përkujdesje Social -Psikologjike

2- Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike, sipas percaktimit te nenit 55, pika 6-të e ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

I paraqitet Këshillit Bashkiak për të marrë vendimin

**KRYETAR
MARK BABANI**

**NË MUNGESË DHË ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Kristian Shkreli**



Konceptoi: Specialist. Aurela Deda
Miratoi: P/Sektori I Shërbimit Social. Çuka Babani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

Nr. _____ Prot

Vau Dejës me _____.____.2023

RELACION

Bazuar në **Ligjin 139/2015** "Për Vetëqeverisjen Vendore", në **Ligjin 121/2016** "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", në **VKM 518 Datë 04.09.2018** "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat për përfitimin e tyre dhe Masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", **Kreu III-Procedurat**, Pika 13-a); Pika 14; Pika 17; Pika 18; Pika 23-a); Pika 24. **Kreu IV** "Kriteret e Përfitimit të Shërbimit dhe Përmbajtja e Dosjes" Pika 58-Ç), Pika 59.

Zj.Gjelinë Toma ka paraqitur kërkesen pranë Sektorit të Shërbimit Social, Bashkia Vau Dejës, për sistemim në Qendrën e Përkujdesit për të Moshuar "**Besa**", Barbullush. Zj. Gjelinë Toma është shprehur se ka humbur bashkëshortin dhe se jeton e vetme. Ajo e ka të pamundur të kujdeset për veten e saj si nga ana ekonomike ashtu dhe nga gjëndja e saj shëndetësore. Banesa ku ajo jeton nuk plotëson kushtet minimale për të jetuar, për shkak se banesa është djegur më përpara dhe ka vetem një riparim të pjesshëm. E gjendur në kushte të tilla dhe e braktisur nga të afërmit kërkon që të sistemohet në një qendër të moshuarish pasi socializimi me të tjerët dhe shërbimi në qender do bënte që të kalonte ditë më të qeta dhe më të lumtura.

Komisioni multidisiplinar i ngritur me urdherin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 13 datë 09.03.2023 "Per ngritjen e Komisionit Multidisiplinare per vlersimin e rasteve te personave qe kanë nevojë për shërbimet e kujdesit shoqërore, komunitare dhe rezidenciale publik dhe jopublik" beri vlersimin e dokumentacionit. Nisur sa me sipër e moshuara Gjelinë Toma plotëson kriteret sipas dokumentave dhe të dhënave :


- a) Certifikatë personale nga Rregjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010
- b) Ceritfikaten Familjare nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile i vitit 2010
- c) Fotografi te individit 2 (cope);
- ç) Raportin mjekesor qe percakton gjendjen shendetesore
- d) Vërtetim nga sigurimet shoqërore me masen dhe llojin e pensionit që përfiton , nga sistemi I Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- e) Vertetimi i gjendjes social-ekonomike te familjes te kryer nga administratori shoqeror sipas formularit te miratuar me udhezim te ministrise pergjegjese per ceshtjet sociale.
- f) Vertetimi nga ZRPP-ja Aluizni per pronat qe ka ne zoterim;
- g) Vertetimin nga sistemi bankar te burimeve financiare te individit; i marre me autorizimin perkates te individit. (Ky verifikim do realizohet ne vazhdim. Mementalisht mbeshtetemi ne deklaraten e nenshkruar nga vetë e moshuari)
- h) Kërkesë për azil.
- i) Vertetim nga Kryetari I Fshatit


Gjithashtu duke ju referuar edhe shqyrtimin e gjendjes sociale të të moshuarës Gjelinë Toma të paraqitur nga administratori shoqeror sipas modelit formular perkates ku rezulton qe e moshuara banon ne një shtëpi pa kushtet minimale dhe në veshtiresi ekonomike, është e vetmuar dhe pa kujdesje nga asnjë njeri.


Nisur nga te dhenat e mesiperme i propozojme Keshillit te Bashkise pranimin e të moshuarës në Qëndren e përkujdesit social per të moshuar "Besa " Barbullush.




Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Komisioni multifunksional i pranimeve









REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Proçesverbal

I mbajtur sot me datë 08/12/2013 nga unë Kryetari i Fshatit Kukël z.Sokol Lanazi paraqes situatën e zj.Gjelinë Toma si më poshtë vijon:

Zj.Gjelinë Toma banore e fshatit Kukël, e lindur me datë 03.03.1950 nëna e 4 fëmijëve , një vajzë e cila jeton jashtë shtetit pa dokumentacion të rregullt, dhe 3(tre) djem nga ku 2 (dy) trajtohen me paaftësi dhe ndodhen ne spitalin e psikiatrikut në Shkodër, dhe tjetri ndodhet jashtë shtetit në kushte të veshtira social ekonomike. Banesa ku ka jetuar e moshuara është djegur dhe nuk plotëson kushtet minimale për të jetuar. Gjithashtu duke pare gjëndjen shëndetësore që ka zj.Gjelinë mendoj se duhet të trajtohet patjetër me kujdes në mënyrë të vazhdueshme. Pasi ajo nuk është në gjendje të kryej shërbimet e veta . Ajo ka qënë e shtruar në spital dhe pas daljes së saj nga spitali ajo ka nevojë për strehim në një qendër për të moshuar për të përfituar nga shërbimet që ofron qendra duke parë që ajo nuk ka kushte social-ekonomike dhe as gjëndje shëndetësore për ti shërbyer vetës së saj. E ndodhur në të tilla kushte pa mbështetje , pa strehim dhe pa shërbim dhe kujdes shëndetësor kërkoj strehimin dhe rahabilitimin e zj.Gjelinë në një qender që plotëson nevojat përshtatur me gjendjen në të cilën ndodhet.

Kryetari i Fshatit:

Sokol Lanazi

